

ARSYETIM PARALEL

Jemi dakord për prishjen e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim po në këtë gjykatë, por konkluzioni ynë mbështetet në një arsyetim tjetër.

Thelbi i vendimit të shumicës përqendrohet në atë, se pretendimet e ngritura nga kërkuesit janë të një karakteri të rëndësishëm kushtetues dhe për pasojë, Gjykata e Lartë duhet të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur lidhur me to. Për pasojë, sipas shumicës, pa u shprehur Gjykata e Lartë lidhur me këto pretendime, nuk mund të shprehet Gjykata Kushtetuese.

Është e vërtetë se pretendimet e parashtruara nga kërkuesit, në përgjithësi, kanë të bëjnë me parime të rëndësishme kushtetuese, të cilat ndikojnë në një masë të madhe në kushtetutshmërinë e procesit të zhvilluar nga gjykatat e zakonshme. Këto pretendime janë ngritur edhe në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, por ky kolegji, pasi ka marrë në shqyrtim rekursin në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, vendim ky që është në pajtim me kuadrin përkatës procedural penal. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë, duke u shprehur se nuk ka shkaqe nga ata që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale, ka mbajtur qëndrim lidhur me pretendimet e ngritura.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese duhet të investojë në ekzaminimin konkret të pretendimeve të ngritura, nëse qendrojnë ose jo, në mënyrë që të konkludojë nëse gjykatat e zakonshme, në instancat përkatëse, kanë zhvilluar process të parregullt ligjor, ashtu siç parashatrojnë kërkuesit, gjë që përbën shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës.

Megjithatë pretendimet e ngritura janë në një numër të madh. ,mendojmë se mund të grupohen në pjesë, dhe konkretisht:

1. Shkelur ndalimi *nullum crimen nulla poena sine lege* (neni 29 i Kushtetutës);
2. Shkelur ndalimi *ne bis in idem* (neni 34);
3. Shkelur parimi i gjykimit nga një gjykatë e krijuar me ligj (neni 42);
4. Shkelur ndalimi se askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme (neni 32/2);
5. Shkelur e drejta e mbrojtjes me avokat (neni 31/ç).

Duke i parë pretendimet e mësipërme të kërkuesve, rezulton se jo të gjitha këto përmenden shprehimisht në nenin 42 të Kushtetutës, por janë të rregulluara në dispozita të tjera të saj si të drejta më vete. Konkretisht, parimi i mosdënimit pa ligj, e drejta e mbrojtjes me avokat, e drejta e mosdënimit mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, e drejta e mosdënimit më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale, janë sanksionuar respektivisht në nenet 29, 31/ç, 32/2 dhe 34 të Kushtetutës. Megjithatë, mendojmë se këto janë parime themelore për një proces të drejtë penal dhe si të tilla janë aspekte të rëndësishme për respektimin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese duhet të angazhohet në ekzaminimin e pretendimeve të kësaj natyre, të cilat kanë të bëjnë me esencën e një procesi të drejtë penal.

1. Pretendimi për shkeljen e parimit të mosdënimit pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*) (neni 29 i Kushtetutës).

Sipas kërkuesve, në kohën kur gjykatat deklarojnë krijimin e organizatës kriminale, vepra penale e trafikut të narkotikëve nuk parashikohej në Kodin Penal, gjë që sipas kërkuesve, vjen në kundërshtim me ndalimin *nullum crimen nulla poena sine lege*, të sanksionuar në nenin 29 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Siç është shprehur në disa vendime të saj, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, garancia e mishëruar në nenin 7 të Konventës (e sanksionuar me të njëjtën forcë edhe në nenin 29 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë), ... është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Kjo garanci duhet të interpretohet dhe aplikohet në mënyrë të tillë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar (*çështja Streletz*).

Ndalimi i sanksionuar në dispozitat e mësipërme shfaqet në disa aspekte. Kështu, ky ndalim kërkon që deklarimi i fajësisë, për pasojë edhe dënimi respektiv, duhet të bazohet në një ligj të shkruar, ndërsa ligji i pashkruar nuk mund të përbëjë bazë për përgjegjësinë penale. (Ky parim në të drejtën romake shprehej me formulën *nullum crimen, nulla poena sine lege scripta*) Një aspekt tjetër i ndalimit është moszbatimi i analogjisë (*nullum crimen, nulla poena sine lege stricta*). Analogjia

penale, ka për qëllim të justifikojë fajësinë dhe dënimin e të akuzuarit, duke bërë transferimin e një legjislacioni në një situatë tjetër pa ligj (për shkak të boshllëkut ligjor). Me qëllim mbrojtjen e të akuzuarit, analogjia penale është e ndaluar (neni 1/c, paragrafi II i Kodit Penal). Ndërsa, aplikimi i analogjisë penale kur është në favor të të akuzuarit është i lejuar. Një aspekt tjetër i këtij ndalimi është moszbatimi i ligjeve me fuqi prapavepruese (*nullum crimen, nulla poena sine lege praevia*). Sipas këtij ndalimi nuk mund të jepet dënim me fuqi prapavepruese për një vepër penale, apo një dënim më i rëndë. Ndërshkueshmëria dhe masa e dënimit duhet të kenë qenë përcaktuar në ligj para se të kryhej akti kriminal. Shprehje tjetër e parimit të mësipërm është edhe ndalimi i termave të paqartë në ligjet penale (*nullum crimen, nulla poena sine lege certa*). Kjo do të thotë, se elementet e krimit dhe dënimi përkatës duhet të përcaktohen qartë në ligj. Kjo kërkesë plotësohet kur nga formulimi i dispozitës përkatëse, dhe në rast se është nevoja, me ndihmën e interpretimit nga ana e gjykatës, individit ka mundësi të dijë se cilat veprime apo mosveprime do ta bëjnë atë penalisht përgjegjës.

Në çështjen në shqyrtim, kërkuesit Arben Bërballa dhe Sokol Kovi, ndërmjet të tjerash, janë deklaruar fajtorë dhe janë dënuar për veprën penale të “Organizimit dhe drejtimit të organizatës kriminale me qëllim trafikimin e paligjshëm të narkotikëve”, parashikuar në nenin 284/a të Kodit Penal. Sipas vendimeve të gjykatave të zakonshme, aktiviteti kriminal i kërkuesve është zhvilluar gjatë periudhës 1998 - janar 2001. Vepra penale e sipërpërmendur, për të cilën janë deklaruar fajtorë dhe dënuar kërkuesit është shtuar në Kodin Penal me ligjin nr.8279, datë 15.01.1998 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”. Për pasojë, vepra penale që u është atribuar kërkuesve në atë kohë parashikohej në Kodin Penal.

Në kuadrin e pretendimit të tyre për shkeljen e parimit të sipërpërmendur të mosdënimit pa ligj, kërkuesit kanë arsyetuar se vepra penale e “Trafikut të Narkotikëve” e cila përfshin edhe trafikun ndërkombëtar të narkotikëve, është shtuar në Kodin Penal me ligjin nr.8733, datë 24.01.2001, “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, ku pas nenit 283 është shtuar neni 283/a.

Është e vërtetë se në vitin 2001 në Kodin Penal është shtuar neni 283/a, por siç rezulton nga materialet e dosjes, kërkuesit nuk janë deklaruar fajtorë në bazë të kësaj dispozite, por në bazë të nenit 284/a të Kodit Penal, dispozitë kjo që është miratuar në janar 1998. Siç pranohet edhe në doktrinën e së drejtës penale, në këndvështrimin e pasojave kriminale, në varësi të qenies ose jo të pasojës si element i figurës së veprës penale, këto të fundit, ndahen në materiale dhe formale. Duke e analizuar në këtë vështrim figurën e veprës penale që parashikon neni 284/a, mund të konkludohet se ajo përfshihet në figurat formale të veprave penale, gjë që do të thotë se kjo vepër konsiderohet e kryer që nga momenti i organizimit dhe i pjesëmarrjes në organizatën kriminale pavarësisht nga ardhja e pasojave. Kur nga veprimtaria e organizatës kriminale kanë ardhur edhe pasoja, atëherë veprat penale do të konkurrojnë.

Në këto rrethana, mendojmë se duhet të konkludohet se kërkuesit janë deklaruar fajtorë dhe dënuar për një vepër penale që në kohën e kryerjes parashikohej në ligj, dhe për pasojë, dënimi i tyre për këtë vepër penale nuk është arbitrar.

Në kuadrin e pretendimit për shkeljen e parimit të sipërpërmendur të mosdënimit pa ligj, kërkuesit kanë pretenduar gjithashtu, se në dënimin e tyre gjykatat kanë aplikuar ligjin penal me analogji, gjë që është e ndaluar edhe nga neni 1/c/2 i Kodit Penal.

Duke pasur parasysh nocionin e përgjithshëm të analogjisë të trajtuar edhe më sipër, mendojmë se edhe ky pretendim nuk është i bazuar.

Kështu, në këtë drejtim, si aspekt të aplikimit të analogjisë nga ana e gjykatave të zakonshme, kërkuesit parashitjnë se Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, në faqen 14 të vendimit të saj, ka pranuar se “Kjo analizë e mësipërme rezulton të jetë në materialin e dosjes voluminoze të ardhur nga autoritetet italiane me nr.1010/99 dhe konkretisht në volumnin 11”.

Në kundërshtim me sa pretendojnë kërkuesit, në faqen 14 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, përshkruhen rrethanat e ardhjes në Shqipëri të dy shtetasve kolumbiane, të kontakteve që kanë pasur këtu dhe rrethana të tjera. Në këtë pjesë të vendimit nuk është bërë ndonjë analizë ligjore e çështjes, por analizë e provave, gjë që nuk ka të bëjë me analogjinë. Analogjia, megjithëse në procesin penal është e ndaluar, me përjashtim të rastit kur është në favor të të akuzuarit, ka të bëjë me aplikimin e një situatë ligjore të njohur, për të bërë cilësimin ligjor të një rasti (vepre) për të cilën ka boshllëk ligjor. Pra, në fund të fundit, aplikimi i analogjisë ka të bëjë me cilësimin ligjor që bën gjykata në një

çështje konkrete. Në rastin në shqyrtim, gjykata e shkallës së parë, në këtë pjesë të vendimit të saj, ka analizuar disa rrethana të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 284/a/1 i Kodit Penal, dhe nuk ka bërë ndonjë analizë të cilësimit juridik të veprës. Për pasojë nuk ndodhemi para zbatimit të ligjit me analogji.

Nga ana e tij, kërkuesi Sokol Koçiu, si aspekt të shkeljes së parimit të mosdënimit pa ligj, ka pretenduar, në veçanti, se lidhur me veprën penale të falsifikimit të letërnjoftimeve apo vizave, parashikuar nga neni 189/1 të Kodit Penal, është dënuar me 9 vjet burgim, ndërkohë që maksimumi i dënimit që parashikon kjo dispozitë është 5 vjet burgim.

Edhe ky pretendim i kërkuesit nuk është i bazuar.

Është e vërtetë se në mbajtjen e procesverbalit apo në zbardhjen e vendimit gjyqësor është shënuar sikur kërkuesi është denuar me 9 vjet burgim, por mendojmë se ky përbën një gabim material për shkak të një sërë rrethanash. Kështu, lidhur me veprën penale të falsifikimit, parashikuar nga neni 189/1 të Kodit Penal, siç rezultojnë edhe nga procesverbali gjyqësor, prokurori i çështjes për këtë vepër penale ka kërkuar dënimin me 9 muaj burgim. Po kështu, edhe nga dorëshkrimi i vendimit të gjykatës rezultojnë se kërkuesi për këtë vepër penale është dënuar me 9 muaj burgim. Përveç kësaj, edhe bashkëpunëtori tjetër Frederik Durda për këtë vepër është dënuar me 9 muaj burgim. Dhe më në fund, duke bërë bashkimin e dënimeve në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, 12 vjet burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 284/a/1 të Kodit Penal, 10 vjet burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 333 të Kodit Penal dhe 9 muaj burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 189 të Kodit Penal, duke zgjedhur sistemin e dënimit më të rëndë të shtuar, e ka dënuar me 15 vjet heqje të lirisë. Nga të gjitha këto rrethana mund të arrihet në përfundimin se për veprën penale të falsifikimit të letërnjoftimeve dhe vizave kërkuesi është dënuar jo me 9 vjet burgim, por me 9 muaj burgim, dhe se shënimi i pretenduar përbën gabim material.

2. Pretendimi për shkeljen e parimit të mosdënimit më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*) (neni 34 i Kushtetutës dhe neni 4 i protokollit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut).

Kërkuesit kanë pretenduar se në shkelje të këtij parimi kushtetues ata janë dënuar dy herë për të njëjtën vepër penale të “Organizimit dhe drejtimit të organizatave kriminale”, një herë sipas nenit 284/a/1 të Kodit Penal dhe një herë sipas nenit 333 të po këtij Kodi.

Ndalimi kushtetues i dënimit më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale është shprehje e parimit të së drejtës penale, se denimi duhet të jetë i drejtë, d.m.th. se denimi duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, me rrethanat e kryerjes së veprës dhe personalitetin e të akuzuarit. Ky parim përjashton deklarimin fajtor dhe dënimin më shumë se një herë të të akuzuarit për të njëjtën vepër penale, për të cilën është dhënë një herë një vendim përfundimtar, apo cilësimin e së njëjtës vepër penale sipas dispozitave të ndryshme penale, kur cilësimi ligjor i veprës një herë bëhet sipas një ligji të përgjithshëm dhe një herë sipas një ligji të posaçëm, ose kur njëra dispozitë mund të quhet si nënseksion i një dispozite tjetër. Ndalimi përjashton gjithashtu konsiderimin në të njëjtën kohë të një rrethane si rrethanë cilësuese dhe si rrethanë rënduese. Sipas të drejtës penale, një denim i mëparshëm nuk mund të merret parasysh më tepër se një herë për qëllimet e përcaktimit të dënimit në rastet kur denimi përbën një rrethanë rënduese të palidhur me cilësimin ligjor të veprës penale. Po kështu, një denim i mëparshëm nuk mund të merret në konsideratë përsëri në rastin kur koncepti i “veprës penale të përsëritur” apo i “kryerjes së një vepre penale nga një person i cili ka kryer tashmë një vepër penale” përdoret si argument në mbështetje të dënimit (deklarimit fajtor). Siç është shprehur Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në çështjen Franz Fischer kundër Austrisë, fakti se një akt i vetëm përbën më tepër se një vepër penale nuk është në kundërshtim me këtë parim. Megjithatë, ka raste, kur një sjellje (akt) kriminale, në pamje të parë, duket se përbën më tepër se një vepër penale, megjithëse një ekzaminim më i kujdesshëm tregon se duhet të procedohet vetëm një vepër penale sepse, kjo e fundit (vepra penale) përfshin të gjitha shkeljet që përfshihen në veprat e tjera. Një shembull i dukshëm do të ishte sjellja (akti) kriminale, e cila përbën dy vepra penale, njëra prej të cilave përmban ekzakt të njëjtët elemente si tjetra plus edhe një tjetër. Për pasojë, duhet të ekzaminohet nëse të tilla vepra penale kanë ose jo të njëjtat elemente të domosdoshëm.

Në vështrim të konsideratave të mësipërme, si dhe duke pasur parasysh pretendimin konkret të kërkuesve, si dhe formulimin e nenit 34 të Kushtetutës se “Askush nuk mund të dënohet më shumë se

një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish ...”, çështja shtrohet, nëse kërkuesit janë dënuar më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale.

Nga vendimet e gjykatave të zakonshme rezultojnë se kërkuesit janë deklaruar fajtorë dhe dënuar për veprat penale të “Organizimit dhe drejtimit të organizatës kriminale me qëllim trafikimin e narkotikëve”, parashikuar nga neni 284/a/1 të Kodit Penal dhe atë të “Krijimit të bandës së armatosur dhe të organizatës kriminale”, parashikuar nga neni 333 i Kodit Penal.

Për të konkluduar nëse kërkuesit janë dënuar më shumë se një herë për të njëjtën vepër, Gjykata duhet të verifikojë nëse këto vepra penale kanë të njëjtat elemente të domosdoshme. Kështu, të dyja figurat e veprave penale që parashikojnë nenet 284/a/1 dhe 333 të Kodit Penal, parashikojnë krijimin dhe drejtimin e organizatave kriminale, por dallimi ndërmjet tyre qëndron në atë që organizata kriminale që parashikon dispozita e parë ka një qëllim të posaçëm, atë të “trafikimit të lëndëve narkotike”, ndërsa organizata që parashikon dispozita tjetër, është e përgjithshme. Përveç kësaj, e njëjta veprimtari me qëllim trafikimin e narkotikëve që ka formuar anën objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 284/a/1 i Kodit Penal, e cila është një sjellje e posaçme, përbën anën objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 333 i Kodit Penal. Për pasojë, e njëjta sjellje, në të njëjtën kohë, është cilësuar edhe sipas një dispozite që parashikon një vepër të përgjithshme penale (neni 333 i Kodit Penal) edhe sipas një dispozite që parashikon një vepër të posaçme penale (neni 284/a/1 i po këtij Kodi), gjë që është e papranueshme. Këtu kemi parasysh edhe faktin se nuk është vërtetuar se në planin e veprimtarisë së tyre kriminale, kërkuesit kishin përfshirë edhe kryerjen e krimeve të tjera, përveç trafikimit të narkotikëve.

Për pasojë, mendojmë se kërkuesit janë dënuar më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale, gjë që vjen në kundërshtim me nenin 34 të Kushtetutës.

3. Pretendimi për shkeljen e parimit të gjykimit nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*” (neni 42/2 i Kushtetutës).

Mendojmë se, fraza “*gjykatë ... e caktuar me ligj*” në nenin 42/2 të Kushtetutës mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështje konkrete. Për pasojë, është e nevojshme të ekzaminohen pretendime të tilla si ato në rastin në shqyrtim, lidhur me shkeljen e rregullave ligjore për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të një trupi gjykues, dhe konkretisht të nenit 28/4 të ligjit nr.8436, date 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Kërkuesit kanë pretenduar se në caktimin e gjyqtarëve të apelit për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Tiranë, në rastin në shqyrtim, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e mësipërme. Sipas kërkuesve nuk rezultojnë se gjyqtarët e caktuar kanë dhënë dorëheqjen për shqyrtimin e çështjes në ngarkim të tyre, dhe për pasojë, nuk është e vërtetë se në Gjykatën e Apelit Tiranë nuk mund të formohet trupi gjykues për gjykimin e kësaj çështjeje.

Ky pretendim është i pabazuar. Sipas nenit 28/4, të ligjit të mësipërm, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, mund të emërojë një gjyqtar të gjykojë një numër çështjesh në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel, nëse mungojnë gjyqtarët në këtë gjykatë. Në rastin në shqyrtim, siç rezultojnë edhe nga materialet e dosjes, në kundërshtim me sa pretendojnë kërkuesit, disa nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, kanë dhënë dorëheqjen, dorëheqje që është pranuar nga kryetari i kësaj gjykate në bazë të rregullave të Kodit të Procedurës Penale, dhe si rezultat në këtë gjykatë kanë munguar gjyqtarët për të formuar trupin gjykues për shqyrtimin e çështjes në ngarkim të kërkuesve. Për pasojë, ka qënë pikërisht rasti që parashikon dispozita e mësipërme e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor ...” kur Këshilli i Lartë i Drejtësisë cakton gjyqtarë për të gjykuar për llogari të një gjykate tjetër.

Përsa më sipër, mendojmë se nuk ka shkelje të parimit të gjykimit nga një *gjykatë e caktuar me ligj*, parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës.

4. Pretendimi për shkeljen e parimit të mosdeklarimit fajtor dhe të mosdënimit mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme (neni 32/2 i Kushtetutës).

Lidhur me këtë pretendim, mendojmë se pranimi i provave është çështje që u takon gjykatave të zakonshme. Detyra e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse procesi i realizuar në këto gjykata, i shqyrtuar si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qënë i drejtë. (Shih: ISGRO) Normalisht, të gjitha provat duhet të paraqiten në prani të të akuzuarit, në një seancë publike me qëllim që të realizohet një proces kontradiktor. Megjithatë, përdorimi si prova i thënieve të marra në

fazën (e hetimit) paraprake, si dhe në kushtet që parashikon neni 369/3 i Kodit të Procedurës Penale, nuk është, në vetvete, i papajtueshëm me paragrafët 3 (d) dhe 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ose nenet 31/d dhe 42 të Kushtetutës), me kusht që të respektohet e drejta e mbrojtjes. Si rregull, këto të drejta kërkojnë që të akuzuarit t'i jepet një mundësi e përshtatshme për të kundërshtuar një dëshmitar kundër tij (Shih: KOSTOVSKI). Për pasojë, është e domosdoshme të verifikohet nëse kërkuesit e kanë patur këtë mundësi.

Si aspekte të shkeljes së nenit 32/2 të Kushtetutës kërkuesit kanë parashtruar se dëshmia e të quajturës L.Cestari është marrë në shkelje të nenit 31/d të Kushtetutës dhe nenit 6/1/3 (d) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë kuadër kërkuesit kanë pretenduar gjithashtu se janë shkelur rregullat procedurale edhe në caktimin e përkthyesit që ka asistuar në procesin e pyetjes së dëshmitares në ekzekutim të letërporosisë si dhe në zhvillimin e njohjes me fotografi nga ana e dëshmitares L.Cestari.

- Lidhur me pyetjen, me cilësinë e dëshmitares, të shtetases italiane L.Cestari, nga materialet e dosjes rezulton se organet e procedimit si dhe gjykata kanë vepruar në perputhje me kuadrin procedural përkatës. Kështu, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, mbi kërkesën e prokurorit të çështjes, në bazë të neneve 509 e vijues të Kodit të Procedurës Penale si dhe në bazë të Konventës së Keshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale” të datës 20 Prill 1957 dhe të Protokollit shtesë të datës 17 Mars 1997, të ratifikuar me ligjin nr.8498, date 10.06.1999, meqë u janë drejtuar me letërporosi autoriteteve italiane, me qëllim që të bënin të mundur paraqitjen e të sipërpërmendurës përpara gjykatës për të dëshmuar në procesin në ngarkim të kërkuesve. Meqë dëshmitarja është shprehur se nuk mund të paraqitej përpara Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për të dëshmuar, kjo gjykatë u është drejtuar përsëri autoriteteve përkatëse italiane që të bënin të mundur pyetjen e dëshmitares në vendbanimin e saj në Itali. Në këtë mënyrë, në përputhje me Konventën e sipërpërmendur si dhe në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale Italiane, pyetja e dëshmitares është realizuar nga ana e Gjykatës së Apelit, Romë në datën 25.11.2002. Në procesin e pyetjes kanë marrë pjesë edhe avokatët e caktuar nga gjykata kryesisht, meqë avokatët e zgjedhur nga kërkuesit nuk kanë pranuar, prokurorët e çështjes si dhe tre anetarët e trupit gjykues të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Procesverbali si dhe materiali i incizuar në ekzekutim të letërporosisë i është dërguar nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, gjykatës së shkallës së parë, dhe më pas është administruar nga ana e kësaj gjykate në seancë gjyqësore në prani të kërkuesve.

Edhe për caktimin e përkthyesit si dhe për zhvillimin e njohjes me fotografi mendojmë se nuk ka shkelje. Në këtë rast, siç rezulton nga materialet e dosjes, veçanërisht nga procesverbali përkatës, në këtë drejtim organet e procedimit kanë respektuar rregullat procedurale.

Në këto kushte, në kundërshtim me sa pretendojnë kërkuesit, pyetja e dëshmitares L.Cestari është bërë në përputhje me nenin 31/d të Kushtetutës si dhe me nenin 6/3 (d) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

- Si aspekt tjetër të shkeljes së nenit 32/2 të Kushtetutës kërkuesit kanë parashtruar cilësimin si dëshmi të thënieve të shtetasit kolumbian T. Mateus, thëniet e të cilit, sipas kërkuesve janë pranuar si provë në kundërshtim me rregullat procedurale.

Lidhur me këtë pretendim, nga materialet e çështjes rezulton, se nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me anën e letërporosive datë 02.02.2001, date 04.03.2002 dhe datë 14.05.2002, drejtuar autoriteteve gjyqësore italiane të bënin të mundur dërgimin e disa materialeve që lidheshin me dëshminë e dëshmitarit T. Mateus. Autoritetet gjyqësore italiane, bazuar në Traktatin “Për asistencë reciproke në fushën penale” midis Republikës Italiane dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i kanë dërguar SHBA-së letërporosinë për pyetjen me cilësinë e dëshmitarit të shtetasit kolumbian T. Mateus, që gjendej i arrestuar pranë Zyrrave Federale të Shtetit New York, pyetje që është realizuar në datën 30.01.2002. Më pas, në ekzekutim të letërporosive të sipërpërmendura, autoritetet italiane i kanë dërguar Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, materialet që pasqyrojnë dëshminë e T.Mateus, marrë në pyetje nga autoriteti procedues përkatës i Nju Jorkut, material i dërguar edhe i incizuar. Siç rezulton nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë, këto materiale janë administruar nga kjo gjykatë, në kuadrin e leximeve të lejueshme, si “deklarime të bëra nga shtetasi i huaj jashtë shtetit” në bazë të nenit 369/3 të Kodit të Procedurës Penale, material i cili, sipas gjykatës, është vlerësuar duke u lidhur me provat e tjera.

Përsa më sipër, edhe lidhur me administrimin e deklarimeve të të quajturit T. Mateus

mendojmë se nuk konstatohet shkelje.

Në rastin në shqyrtim, megjithëse gjykatat, nuk kanë qenë në gjendje të realizonin pyetjen personalisht të dëshimtarëve L.Cestari e T.Mateus, kjo nuk do të thotë se ato i kanë bazuar vendimet e tyre, vetëm, apo në një masë të madhe, në dëshmitë e marra nëpërmjet letërporosive. Ato janë bazuar edhe në dëshmitë e tjera, të marra në seancë gjyqësore dhe të dëshimtarëve të pyetur në fazën e hetimit gjyqësor, si dhe në një sërë dokumentesh dhe provash materiale.

Prandaj, mendojmë se ndonjë kufizim, i cili mund të jetë i imponuar mbi të drejtat e mbrojtjes, nuk kanë qenë të tilla sa të privojnë kërkuesit nga një gjykim i drejtë. Për pasojë, mund të konkludohet se nuk ka patur shkelje të nenit 6/1/3 (d) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe të neneve 31/d dhe 32/2 në lidhje me nenin 42 të Kushtetutës.

- Edhe pretendimi se aktet e dosjes nr.1010/99 të ardhura nga Italia, nuk mund të konsiderohen si prova të vlefshme, mendojmë se nuk është i bazuar. Nga materialet e dosjes rezulton se dosja e mësipërme, në ekzekutim të letërporosive të sipërpërmendura, është dërguar nga ana e autoriteteve italiane, në rrugë institucionale, duke respektuar të gjithë procedurën përkatëse që parashikon Kodit i Procedurës Penale si dhe Konventa përkatëse e Këshillit të Europës.

5. Pretendimi për shkeljen e të drejtës së mbrojtjes me avokat, parashikuar nga neni 31/ç në lidhje me nenin 42 të Kushtetutës si dhe neni 6/1/3c të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Mendojmë se edhe ky pretendim nuk është i bazuar. Nga materialet e dosjes rezulton se kërkuesit janë mbrojtur nga avokatë të zgjedhur nga vetë ata. Për shkeljen e kësaj të drejte kërkuesit i referohen seancës gjyqësore të datës 18.03.2003 të zhvilluar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë. Në këtë seancë, gjykata e ka përjashtuar avokatin e kërkuesit Sokol Koçiu, për shkelje të rregullave të seancës gjyqësore, dhe në vend të tij ka caktuar kryesisht një avokat tjetër. Me caktimin e këtij avokati seanca këtë datë nuk ka vazhduar më.

Në këto rrethana, mendojmë se caktimi i një avokati kryesisht për kërkuesin Sokol Koçiu në vend të avokatit të zgjedhur prej tij, nuk ka çështur të drejtën e mbrojtjes së kërkuesit. Për më tepër, këtu kemi parasysh se kjo seancë zë një hapësirë shumë të vogël në vëllimin e seancave gjyqësore për gjykimin e kësaj çështje.

Për të gjitha argumentet e parashtruara më sipër, mendojmë se përderisa konstatohet shkelja e ndalimit të mosdënimit më shumë se një here për të njëjtën vepër penale, vendimi i kolegjit Penal të Gjykatës së Lart duhet të deklarohet si antikushtetues dhe çështja të dërgohet për shqyrtim në po atë gjykatë.

Tiranë më 29.12.2005

Anëtarë: P.Plloçi, S.Sadushi, Xh. Zaganjori